

V E N D I M
Nr.1, datë 7.1.1999

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.152, DATË
5.4.1994 "PËR KUSHTET E PËRFITIMIT, SHUMËN DHE PROCEDURËN E DHËNIES
SË PENSIONEVE TË POSAÇME SHTETËRORE DHE TË SHITESAVE TË
PENSIONEVE"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, të ligjit nr.7709, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave,

V E N D O S I:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.152, datë 5.4.1994, pika 2 ndryshohet si vijon:
"Kërkesa ose propozimi për përfitimin e pensionit të posaçëm ose të shtesës së pensionit, bëhet nga i interesuari, organizatat ose shoqatat, vetëm nëpërmjet këshillit të bashkisë ose rrethit të vendbanimit të personit, si dhe nga ministritë dhe institucionet qendrore".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E M I N I S T R I
Pandeli Majko